



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

ISLAMI – FE E PËRSOSUR

Muhamed el-Muhtar esh-Shenkiti

Botuar nga: Botues Privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit: Bledar Aliu

PARATHËNIA	4
ÇËSHËTJA E PARË: TEUHIDI	6
ÇËSHËTJA E DYTË: PREDIKIMI	11
ÇËSHËTJA E TRETË: DALLIMI MIDIS VEPRËS SË MIRË DHE DIÇKAJE TJETËR.....	14
ÇËSHËTJA E KATËRT: GJYKIMI ME DIÇKA TJETËR VEÇ SHERIATIT ISLAM	17
ÇËSHËTJA E PESTË: STATUSI INDIVIDUAL	20
ÇËSHËTJA E GJASHTË: EKONOMIA	25
ÇËSHËTJA E SHTATË: POLITIKA.....	27
ÇËSHËTJA E TETË: DOMINIMI I JOBESIMTARËVE MBI MUSLIMANËT.....	31
ÇËSHËTJA E NËNTË: DOBËSIMI I MUSLIMANËVE NË NUMËR E FUQI NË KRAHASIM ME JOBESIMTARË.....	32
ÇËSHËTJA E DHJETË: PROBLEMI I PËRÇARJES SË ZEMRAVE	37

PARATHËNIA

Falenderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqa dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi pejgamerin tonë Muhamedin, familjen e tij, shokët e tij dhe këdo që fton me thirrjen e tij deri në Ditën e Kijametit.

Origjina e këtij libërthi është një ligjëratë të cilën e mbajta në xhaminë e profetit, sipas kërkesës së mbretit të Marokut. Njëri prej vëllezërve të mi më kërkoi që ta shkruaj për arsye që të botohet e të shpërndahet. Unë iu përgjigja me kënaqësi kërkesës së tij, duke shpresuar prej Allahut që të ketë dobi prej tij.

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

"Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova mirësinë time mbi ju dhe zgjedha për ju Islamin si fe." [Sure El-Maide: 3]

Ajo ditë ishte dita e Arafatit dhe dita e xhuma në haxhin e lamtumirës. Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) në pasditen e asaj dite ishte duke qëndruar në Arafat. Ai pas zbritjes së këtij ajeti jetoj edhe tetëdhjetë e një netë. Allahu i Lartëmadhëruar e tregoi qartë në këtë ajet se e ka përsosur fenë tonë dhe në të nuk ka asgjë të mangët e asnjëherë nuk ka nevojë për asnjë shtesë. Për këtë arsye u ndërpre dërgimi i pejgamberëve me pejgamberin tonë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Allahu i Lartësuar e tregoi qartë se ka zgjedhur Islamin

për ne, e në këtë fe nuk ka për tu inatosur asnjëherë. Ai ka theksuar se nuk ka për të pranuar asnjë fe tjetër përveç Islamit prej askujt. Allahu thotë:

"Kushdo që kërkon ndonjë fe tjetër përveç Islamit, ajo nuk do t'i pranohet atij dhe në botën tjetër ka për të qënë prej të humburve." [Sure Ali Imran:85]

"Nuk ka dyshim që feja e pranuar tek Allahu është vetëm Islami." [Sure Ali Imran:19]

Me përsosjen e fesë dhe me sqarimin e rregullave të saj janë arritur begatitë e të dy botëve, prandaj Allahu thotë:

"Plotësova mirësinë Time mbi ju." [Sure El-Maide:3]

Në këtë ajet Kur'anor është sqaruar qartë se feja Islame nuk ka lënë asnjë gjë e cila u nevojitet krijesave në lidhje e këtë botë apo botën tjetër pa e sqaruar çfarëdo qoftë ajo. Këtë që përmendëm do ta parashtrojmë duke sqaruar dhjetë çështje madhështore, rreth të cilave sillet kjo botë, çështje të cilat u interesojnë krijesave në të dy vendbanimet. Në disa prej tyre do të shtjellohem duke sqaruar gjëra me shumë interes. Ato janë:

1. Teuhidi (njëshmëria e Allahut)
2. Predikimi
3. Dallimi midis veprës së mirë dhe diçkaje tjetër
4. Gjykimi me diçka tjetër veç sheriatit Islam
5. Statusi individual

6. Ekonomia
7. Politika
8. Problemi i dominimit të jobesimtarëve mbi muslimanët
9. Problemi i dobësisë së muslimanëve në rezistencë kundra jobesimtarëve në numër dhe aftësi
10. Problemi i përçarjes së zemrave në shoqëri

Në rreshtat e mëposhtëm me anë të Kur'anit do të sqarojmë ilaçin e të gjitha këtyre problemeve. Ky është një tregues i vrullshëm që sqaron gjithçka me Kur'an, duke synuar me anë të tij argumentet e tjera.

ÇËSHTJA E PARË: TEUHIDI

Është bërë e ditur me anë të studimit të Kur'anit se teuhidi ndahet në tre lloje.

1- Njëshmëria e Allahut të Lartësuar në rububije (në veprat e Tij).

Me këtë lloj të teuhidit janë karakterizuar natyrshmëritë e pastra të njerëzve të zgjuar. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, patjetër që do të thonë: Allahu!" [Sure Ez-Zukhruf: 87]

"Thuaj: Kush ju sjell furnizim nga qielli dhe nga toka, kush është zotëruesi i të shikuarit dhe të dëgjuarit? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli? Kush është rregulluesi dhe sunduesi i të gjitha çështjeve? Do të thonë të gjithë: Allahu! Thuaju: A nuk po frikësoheni (nga ndëshkimi i Allahut)?" [Sure Junus: 31]

Ajetet e Kur'anit në lidhje me këtë temë janë të shumta. Faraoni e mohoi këtë lloj të teuhidit. Allahu i Lartësuar thotë:

"Faraoni tha: E çfarë është Zoti i botëve? " [Sure Shuara: 23]

Por mohimi i faraonit ishte një arrogancë dhe injorancë e qëllimshme. Argument për këtë është fjala e Allahut kur thotë: "(Musai) i tha: Në të vëtetë ti tashmë e more vesh se këto shenja nuk janë zbritur nga askush veçse nga Zoti i qiejve dhe tokës si dëshmi e qartë (për të hapur sytë në shenjat e njësisë së Allahut)." [Sure El-Isra: 102]

Gjithashtu thotë Allahu:

"Dhe ata i përgënjeshtroan ato (ajetet tona) padrejtësisht dhe me mospërfillje edhe pse në veten e tyre ishin të bindur për to." [Sure En-Neml: 14]

Po të pëqendrohesh me kujdes, Kur'ani në fillim zbriste në ngulitjen e këtij teuhidi në formën e pyetjes retorike, siç ka ardhur në Kur'an:

"A ka dyshim për Allahun?" [Sure Ibrahim: 10]

"Thuaj: A mos vallë duhet të kërkoj zot tjetër përveç Allahut, ndërkohë që Ai është Zoti i gjithçkaje?" [Sure En-Aam: 64]

"Thuaj: Kush është Zot i qiejve dhe i tokës? Thuaj (është) Allahu." [Sure Err-Rrad: 16]

Këto ishin disa prej atyre ajeteve, ndërkohë që ka edhe të tjera, sepse ata e pohonin këtë lloj të teuhidit. Ky lloj teuhidi nuk i bën aspak dobi jobesimtarëve, sepse ata nuk e njehsuan Allahun në adhurim. Allahu thotë:

"Dhe shumica e tyre nuk e besojnë Allahun veçse duke i bërë atij shok e ortak si të barabartë me të." [Sure Jusuf: 106]

"Ne i adhurojmë ata për arsye që ata të mund të na afrojnë tek Allahu." [Sure Ez-Zumer: 3]

"Këta janë ndërmjetësit tanë tek Allahu. Thuaju: A mos e njoftoni Alahun për çfarë Ai nuk e di." [Sure Junus: 18]

2- Njeshmëria e Allahut të Lartëmadhëruar në adhurimin e Tij.

Për shkak të këtij teuhidi kanë ndodhur të gjitha luftrat midis të dërguarve dhe popujve të tyre. Për shkak të zbatimit të tij janë dërguar të dërguarit. Thelbi i tij është të kuptuarit e fjalës: LA ILAHE IL-LA ALLAH: Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Allahut. Kjo fjalë është ndërtuar mbi dy baza: mohim dhe pohim.

- Mohimi është: Braktisja e të gjithë të adhuruarve përveç Allahut të Lartëmadhëruar në të gjitha llojet e adhurimit çfarëdo qoftë ai.

- Pohimi është të njehsohet vetëm Allahu me të gjitha llojet e adhurimit në mënyrën që Ai e ka vendosur të adhurohet me të.

Pjesa më e madhe e Kur'anit flet për këtë lloj të teuhidit. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe vërtet që Ne kemi dërguar në çdo popull të dërguar (duke shpallur): Adhurojeni vetëm Allahun dhe shmanguni e rrini larg tagutit (gjithçka që adhurohet përveç a përkrah Allahut).” [Sure En-Nahl: 36]

“Dhe Ne nuk kemi sjellë ndonjë të dërguar para teje (o Muhamed) e që Ne të mos i kemi frymëzuar (duke i thënë): La ilahe ila Ena (Nuk ka të adhuroar tjetër të merituar veç Meje - Allahut). Kështu që më adhuroni Mua të vetëm e askënd tjetër.” [Sure Enbija: 25]

“Kushdo që mohon tagutin dhe beson Allahun, atëherë ai ka rrokur mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë.” [Sure Bekare: 256]

“Dhe pyet (o Muhamed) ata nga të dërguarit tanë të cilët Ne i dërguam para teje, a caktuam Ne ndonjëherë zota për tu adhuroar në vend të të Gjithëmëshirshmit (Allahut).” [Sure Ez-Zukhruf: 45]

“Thuaj (o Muhamed): Më është shpallur mua se adhuroari juaj është një Zot (I vetëm Allahu). A do t'i nënshtroheni pra Atij duke qënë muslimanë.” [Sure El-Enbija: 108]

Ajetet e Kur'anit në lidhje me këtë çështje janë të shumta.

3- Njëshmëria e Allahut të Lartëmadhëruar në emrat dhe cilësitë e Tij.

Allahu i Lartëmadhëruar ka sqaruar se ky lloj teuhidi është i ndërtuar mbi dy baza:

E para: Allahu i Lartësuar është larg prej ngjasimit me cilësitë e krijesave (e krijesat nuk i ngjasojnë Atij aspak).

E dyta: Të besuarit në çdo gjë me të cilën e ka cilësuar Allahu veten e Tij, ose që e ka cilësuar me të i dërguari i Tij (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Gjithashtu duke besuar se kjo është e vërtetë dhe jo kuptimim figurativ apo simbol i diçkaje tjetër. Ky besim kryhet në mënyrën që i përshtatet përsosmërisë dhe madhërisë së Tij. Është e njohur se nuk mund ta cilësojë Allahun ndonjë më i dijsëm se Allahu për veten e Tij dhe nuk e cilëson Allahun – veç Allahut - ndonjë më i dijsëm për Allahun se i dërguari i Tij. Thotë Allahu i Lartësuar për Vetën e Tij:

"A vallë ju e dini më mirë apo Allahu?" [Sure El-Bekare: 140]

Gjithashtu thotë për të dërguarin e Tij (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të):

"Ai nuk flet nga dëshira e tij. Por është vetëm shpallje që i frymëzohet." [Sure En-Nexhm: 3-4]

Allahu i Lartësuar e ka treguar qartë mohimin e përngjashmërisë të dikujt tjetër me Të duke thënë:

"Asgjë nuk i përngjet Atij."

Dhe më pas tregoi qëndrueshmërinë (pohimin) e cilësive të Tij në formë reale (e jo në mënyrë simbolike) duke thënë:

"Dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." [Sure Esh-Shura: 11]

Fillimi i këtij ajeti nënkupton mosdeformimin e cilësive dhe nga kjo del qëndrueshmëria e cilësive realisht pa i barazuar ato, e mohimi i kësaj (barazisë) bëhet pa deformim. Allahu i Lartëmadhëruar ka treguar qartë se krijesat janë të pafuqishme që të përfshijnë Allahun. Allahu thotë:

"Ai (Allahu) e di çfarë u ndodh atyre (krijesave të Tij) në këtë botë dhe çfarë do tu ndodhë atyre (në botën tjetër) dhe ata kurrë nuk do të përfshijnë gjë nga dija e Tij." [Sure Ta Ha: 110]

ÇËSHTJA E DYTË: PREDIKIMI

Të gjithë dijetarët kanë rënë dakord se Allahu i Lartësuar nuk ka zbritur nga qielli në tokë predikim më të madh e as pengesë më madhështore se predikimi i mbikqyrjes dhe dijes. Le të dijë njeriu se Zoti i tij i Lartësuar është mbikqyrësi i tij dhe është i dijsëm për çdo gjë që ai e fsheh apo e publikon. Dijetarët kanë dhënë në shembull në lidhje me këtë predikim të madh e pengesë madhështore me të cilin bëhet gjëja e menduar si e shikuar duke thënë: Nëse themi se ekziston një mbret që është i njohur për gjakderdhje, vrasës i burrave, barbar dhe ndëshkues i tmerrshëm kundrejt të tjerëve, xhelatët e tij me shpata janë në pritje të urdhërit të tij, copat e mishit të therura janë të hedhura përtokë, shpata kullon gjak dhe rreth mbretit ndodhen vajzat dhe gratë e tij. A mos vallë mund të mendojë dikush se ndonjë nga të pranishmit do të përpiqet të bëjë ndonjë dredhi apo mund të bëjë diçka të ndaluar me vajzat e gratë e mbretit, ndërkohë që ai është prezent dhe shikon se çfarë po bëhet? Jo, kjo është e pamundur. Nuk krahasohet Allahu me të, ngase Allahu ka shembullin më të mirë. Përkundrazi, të gjithë të pranishmit kanë për të qënë të frikësuar e në panik të madh, me zemra të ngrira, sytrembur, gjymtyrët e tyre do të ishin të palëvizura, kulmi i dëshirës së tyre do të ishte vetëm shpëtimi. Allahu nuk krahasohet aspak me të. Pa dyshim që vëzhgimi i Allahut është më madhështor, dija e Tij është shumë më e zgjeruar se dija e atij mbreti, e padyshim që Allahu është ndëshkues më i madh, është më i ashpër në

ndëshkim se kushdo dhe dënimi i Tij është shkatërrimtar. Kufijtë e Allahut që nuk duhen shkelur në tokë janë të ndaluarat (haramet). Nëse banorët e një vendi e dinë se sundimtari i atij vendi ka për të marrë vesh gjithçka që ata veprojnë, natën kanë për të fjetur në panik dhe kanë për t'i lënë prej frikës së tij të gjitha të ndaluarat. Allahu i Lartëmadhëruar ka treguar qartë se qëllimi dhe mençuria e krijimit të krijesave (shkaku për të cilin u krijuan) është që Allahu t'i sprovtojë ata:

"se cilët prej tyre janë më të mirë në vepra." [Sure El-Kehf: 7]

Në fillim të sures Hud ka thënë:

"Dhe është Ai i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe Arshi i Tij ishte mbi ujë, që Ai të mund t'ju provojë ju se cili prej jush është më i miri në vepra." [Sure Hud: 7]

Pra, Allahu në këtë ajet nuk tha: "se kush prej jush ka më shumë vepra." Allahu përsëri thotë në suren El-Mulk:

"I Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën me qëllim që të provojë kush nga ju është më i miri në vepra. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, gjithnjë Falës i Madh." [Sure El-Mulk: 2] Këto dy ajete që përmendëm më lartë përbëjnë kuptimin e fjalës së Allahut ku thotë:

"Dhe Unë (Allahu) nuk i krijova xhindët dhe njerëzit, veçse ata duhet të më adhurojnë vetëm Mua." [Edh-Dhariyat: 56]

Përderisa qëllimi i krijimit të krijesave ishte provimi që u përmend, atëherë Xhibrili dëshiroi që t'ua sqarojë njerëzve rrugën e suksesit në këtë provim, prandaj e pyeti pejgamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), duke i thënë: Më trego për Ihsanin (bamirësinë)? - ndërkohë

që ai është shkak i provimit për të cilin u krijuan krijesat. Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) tregoi qartë se rruga e ihsanit është ky penguesi më i madh dhe predikimi më madhështor të cilin e përmendëm më parë. Ai tha: "Ai (Ihsani) është të adhurosh Allahun sikur e shikon Atë e edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai vërtet të shikon ty." [Trans. Buhariu dhe Muslimi]

Çdo herë që do të shfletosh ndonjë fletë nga Ku'ani Famëlartë, patjetër që do të gjesh në të këtë predikim Madhështor.

"Dhe sigurisht që Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne e dimë se çfarë i pëshpërit atij vetvetja (nefsi i vet). Dhe Ne jemi më afër tij sesa vena e qafës."

"Nuk ka fjalë që ai (njeriu) të nxjerrë nga goja, veçse për të është një vëzhgues pranë tij i gatshëm (për ta shënuar atë)." [Sure Kaf: 16-18]

"Më tej, sigurisht që Ne do t'ju shtjellojmë të gjithë ndodhinë me dijeni të plotë dhe është e vërtetë që Ne nuk kemi munguar (për asnjë çast e në asnjë vend)." [Sure El-A'raf: 7]

"Dhe ti (o Muhamed) nuk bën ndonjë vepër e as nuk këndon ndonjë pjesë nga Kur'ani dhe as ju (njerëz) nuk bëni ndonjë vepër (të mirë ose të keqe), veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju, kur ju e kryeni atë. Dhe asgjë nuk i fshihet Zotit tënd qoftë sa një atom (apo një milingonë qoftë) në tokë a në qiell qoftë. Dhe as çfarë është më e vogël se ajo dhe as çfarë është më e madhe veçse shkruhet në librin e qartë." [Sure Junus: 61, tefsir Et-Taberi]

"Padyshim! A nuk i mbështollën vërtet ata gjokset e tyre që të mund të fshihen prej Tij? Sigurisht që edhe kur ata mbulohen me rrobat e tyre, Ai e di mirë çfarë fshehin dhe çfarë shprehin. Me të vërtetë Ai është i Gjithëdituri (I më të fshehtës) për gjokset tuaja." [Sure Hud: 5]

E kjo gjë ndodhet në çdo vend të Kur'anit.

ÇËSHTJA E TRETË: DALLIMI MIDIS VEPRËS SË MIRË DHE DIÇKAJE TJETËR

Kurani Madhështor ka sqaruar se puna e mirë është ajo punë e cila përmbush tre kushte, e nëse mungon ndonjëra prej tyre, personi që e kryen atë punë nuk do të ketë dobi prej saj në Ditën e Kijametit. Ato janë:

E para: Ajo vepër duhet të jetë në përputhje me traditën e pejgamberit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

Nga Aisheja –Allahu qoftë i kënaqur prej saj - transmetohet se pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kush shpik në çështjen tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar." [Transmeton Buhari dhe Muslimi]

Ka ardhur në një transmetim të hadithit tek imam Muslimi: "Kush vepron një punë që nuk është në çështjen tonë, ajo është e refuzuar."

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

"...dhe çfarëdo që t'ju japë juve i Dërguari, merreni atë, dhe çfarëdo që ai ua ndalon juve, hiqni dorë (prej saj)." [Sure El-Hashr: 7]

"Ai që i bindet të dërguarit (Muhamedit) vërtet ai i është bindur edhe Allahut." [Sure En-Nisa: 80]

"Thuaj (o Muhamed): Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua." [Sure Ali Imran: 31]

"Apo kanë ata shokë të barabartë me Allahun (zota të rremë të tyre) të cilët kanë themeluar e përcaktuar për ta ndonjë fe të cilën nuk e ka urdhëruar e përcaktuar Allahu?" [Sure Esh-Shura: 21]

"Mos vallë ju ka lejuar Allahu (të bëni kështu), apo ju shpifni gënjeshtër ndaj Allahut?" [Sure Junus: 59]

E dyta: Ajo vepër duhet të jetë e sinqertë për Fytyrën e Allahut të Lartëmadhëruar, sepse Allahu thotë:

"Ata nuk u urdhëruan me tjetër veçse që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij." [Sure El-Bejineh: 5]

11 - "Thuaj (o Muhamed): Me të vërtetë jam urdhëruar të adhuroj Allahun me çiltërsi e përkushtim vetëm për hir të Tij."

12 – "Dhe më është urdhëruar (kjo) që të jem i pari i muslimanëve."

13 – "Thuaj (o Muhamed): Me të vërtetë që kam frikë ndëshkimin e një dite të madhe, nëse e kundërshtoj Zotin tim (e nuk i bindem Atij). "

14 - "Thuaj: Vetëm Allahun unë e adhuroj (duke plotësuar detyrat e fesë së Tij) me çiltërsi e përkushtim vetëm për hir të Tij (dhe jo për tu dukur dhe nuk i bashkoj gjë Atij në adhurim)."

15 – "Ndërsa ju adhuroni ç'të doni në vend të Tij." [Sure Ez-Zumer: 11-15]

E treta: Ajo vepër duhet të jetë e ndërtuar mbi themelin e akides së saktë, sepse puna është si çatia, kurse akideja është si themeli.

Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

"Dhe ai që punon nga veprat e mirësisë e drejtësisë duke qënë besimtar ..." [Sure Ta-ha: 112]

Tek ky ajet e lidhi punën me besimin duke thënë: "duke qënë besimtar" e gjithashtu thotë:

"Dhe Ne do t'i kthehemi çfarëdo pune që ata bënë dhe do t'i bëjmë veprat e tilla si grimca pluhuri që fluturojnë në erë." [Sure El-Furkan: 23]

"Të këtyllët janë ata për të cilët nuk ka asgjë në jetën e përtejme veç zjarrit. Ajo që punuan dhe vepruan ata ka dështuar dhe është asgjësuar." [Sure Hud: 16] E shumë ajete të tjera.

ÇËSHËTJA E KATËRT: GJYKIMI ME DIÇKA TJETËR VEÇ SHERIATIT ISLAM

Në Kur'an tregohet qartë se kjo gjë është mosbesim i qartë dhe kjo është njësoj sikur i ke shoqëruar dikë Allahut në adhurim. Një herë shejtani frymëzoi jobesimtarët e Mekës që të pyesin peygamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për delen e cila ngordh, se kush e vret atë (që ngordh). Ai tha: Allahu e vret. Atëherë ai (shejtani) i frymëzoi atyre të thonin: Atë që e therni ju me duart tuaja është e lejuar, kurse atë që e ther Allahu me dorën e Tij fisnike është e ndaluar. Atëherë ju jeni më të mirë se Allahu. [E transmetuan prej Ibn Abbasit, Ebu Daudi, Nesaiu dhe Ibn Maxheh] Atëherë Allahu zbriti fjalën e Tij:

“Dhe vërtet që shejtanët i frymëzojnë miqtë e tyre nga mesi i njerëzve që t’ju kundërshtojnë juve dhe po t’ju bindeni atyre, padyshim që do të ishit idhujtarë (që besojnë në shumë zota).” [Sure En-Aam: 121]

Fundi i ajetit është përcaktuar si lloj betimi, pra, ky është betim në të cilën Allahu i Lartmadhëruar betohet në këtë ajet fisnik se: Kush i bindet shejtanit në ligjin që ai e vendosi kur e bëri të ngordhurën të lejuar, ai është mushrik (idhujtar). Ky është shirku i madh i cili e nxjerr njeriun nga feja Islame dhe ky është edhe mendimi i përgjithshëm i muslimanëve. Allahu ka për ta nënçmuar në Ditën e Kijametit atë person që e vepron këtë duke i thënë:

“A nuk ju urdhërova dhe a nuk jua përcaktova juve, o bijtë e Ademit që të mos adhuroni shejtanin? Vërtet që ai është për ju armik i qartë dhe ju duhet të më adhuroni vetëm Mua. Kjo është Udhë e Drejtë.” [Sure Ja'Sin: 60-61]

Allahu i Lartësuar ka thënë për të dashurin e Tij (Ibrahimin):

“O babai im, mos adhuro shejtanin.” [Sure Merjem: 44] d.m.th (mos e adhuro) duke e ndjekur atë në vendosjen e ligjit të mosbesimit dhe kundërshtimeve të (Allahut). Allahu thotë:

“Ata nuk lusin gjë tjetër veçse perëndi në gjini femërore në vend të Allahut, por ata nuk i drejtohen kujt tjetër veçse shejtanit, një kundërshtues i përhershëm.” [En-Nisa: 117] d.m.th. ata nuk adhurojnë gjë tjetër veç shejtanit duke ndjekur ligjin e tij. Përsëri Allahu thotë:

“Dhe kështu shumë mushrikëve (idhujtarë) shokët e tyre (të ashtuquajturit shokë të Allahut), ua kanë bërë t’u duket krejt e ndershme dhe e drejtë vrasja e fëmijëve të tyre.” [Sure En-Aam: 137] Allahu i Lartësuar i quajti ata shokë (të Allahut), sepse ata iu bindën atyre dhe vranë fëmijët e tyre duke kundërshtuar Allahun.

Adijj ibnu Hatim - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - e pyeti pejgamberin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për fjalën e Allahut kur thotë:

“Ata (çifutët dhe kristianët) morën rabinët dhe murgjit e tyre si perëndi të tyre.” [Sure Et-Teube: 31]

Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) u përgjigj duke thënë se kuptimi i marrjes për perëndi është ndjekja e tyre kur ata ndaluan atë ç’ka lejoi Allahu dhe ndjekja e tyre kur lejuan atë ç’ka ndaloi Allahu. [Transmeton Tirmidhiu]

Kjo është shumë e qartë dhe nuk ka mospajtime në të. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“A i ke parë ata të cilët shtiren sikur besojnë në atë që të është zbritur ty dhe në atë që është zbritur para teje, e ata duan të shkojnë për të gjykuar te tagutët (gjykatësit e rremë, të adhuruarit e trilluar) ndërkohë që janë urdhëruar t’i mohojnë ata. Por është shejtani ai i cili dëshiron t’i çojë ata akoma më tej në rrugë të gabuar.” [Sure En-Nisa: 60]

“E kushdo që nuk gjykon me atë që zbriti Allahu, ata janë kafira.” [El-Maide: 44]

“A të kërkoj gjykues tjetër përveç Allahut, ndërkohë që është Ai i Cili ju ka zbritur librin (Kur’anin) të shtjelluar me imtësi. Ata të cilëve Ne u dhamë librat e parë e dinë se ai është i shpallur nga Zoti yt me të vërtetën, kështu që ti mos ji prej atyre që dyshojnë.” [Sure En-Aam: 114] Dhe Fjala e Allahut të Lartëmadhëruar:

“Dhe Fjala e Zotit tënd është plotësuar me vërtetësi dhe drejtësi. Askush nuk mund t’i ndryshojë fjalët e Tij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri.” [Sure En-Aam: 115]

Fjala e Allahut “Vërtetësi” është përsa i përket lajmeve dhe fjala “Drejtësi” është përsa i përket ligjeve.

“A mos kërkojnë atëherë gjykimin e kohës së padijes? E kush është më i mirë se Allahu në gjykim për një popull që ka besim të fortë.” [Sure El-Maide: 30]

ÇËSHËTJA E PESTË: STATUSI INDIVIDUAL

Kur'ani e ka trajtuar shumë bukur këtë çështje dhe e ka ndriçuar rrugën e saj. Vështro se si e ka urdhëruar udhëheqësin të sillet me shoqërinë e tij.

“Dhe ule krahun tënd me dashamirësi ndaj besimtarëve që të vijnë pas.” [Sure Esh-Shuara: 215]

“Dhe me mëshirën e Allahut (ti Muhamed) u solle butë me ta. Po të kishe qënë i rreptë e me zemër të ashpër, ata do të kishin hequr dorë prej teje, kështu që mos i vër re (gabimet e tyre) dhe kërko falje për ta (nga Allahu) dhe konsultohu me ta për punët.” [Sure Ali Imran: 159]

Vështro si e ka urdhëruar shoqërinë dhe masën e gjerë se si të sillen me udhëheqësit e tyre:

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të dërguarit (Muhamedit) dhe atyre prej jush të cilët janë në drejtimin e udhëheqjen tuaj.” [Sure En-Nisa: 59]

Vështro se si e ka urdhëruar njeriun të sillet me shoqërinë e ngushtë, si me fëmijët dhe bashkëshorten e tij:

“O ju keni besuar! Shmanguni dhe largoni prej vetes tuaj dhe prej familjeve tuaja një zjarr, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, mbi të cillin janë (caktuar) melekë të vrazhdë e të ashpër të cilët nuk kundërshtojnë (dhe janë të vendosur të çojnë në vend) urdhërat që marrin prej Allahut dhe zbatojnë atë që u është urdhëruar.” [Sure Et-Tahrir: 6]

Vështro se si e përqendroi që ta ruaj e ta përforcojë shoqërinë e tij të ngushtë. Gjithashtu e urdhëroi që kur të ndodh diçka e pakënaqshme të mos e vërë re. Pra, së pari e urdhëroi të ruhet e të mbrohet dhe së dyti që të mos i vërë re (gabimet) e të toleroj:

“O ju që keni besuar! Vërtet që ndër gratë tuaja dhe ndër fëmijët tuaj ka armiq për ju (mund t’ju largojnë e t’ju ndalojnë nga bindja dhe nënshtimi ndaj Allahut), atëherë pra jini të vetëdijshëm për ta. Por nëse ju i ndjeni dhe i falni (gabimet e tyre), atëherë vërtet që Allahu është përherë Falës i madh, Mëshirplotë.” [Sure Et-Tegabun: 14]

Vini re se si i ka urdhëruar pjesëtarët e shoqërisë që të sillen me njëri-tjetrin:

“Allahu është Ai që urdhëron për drejtësi, bamirësi dhe ndihmën e bujarinë ndaj gjakut e farefisit dhe Ai ndalon El-Fahsha (politeizmin, imoralitetin etj.), munkerin (gjithçka që ndalon Islami) dhe dhunën. Ai ju qorton dhe ju udhëzon që të mund të përkujtoni e të vini mend.” [Sure En-Nahl: 90]

“O ju që keni besuar! Mënjaroni dyshimet e shumta. Vërtet mjaft nga dyshimet përbëjnë gjynahe. Edhe mos përgojoni njëri tjetrin.” [Sure Huxhurat :12]

“O ju që keni besuar! Mos të tallet një grup me një grup tjetër, mbase mund të jetë se i dyti (i talluri) është më i mirë se i pari (tallësi); As disa gra mos të tallen me gra të tjera, mbase mund të jetë se të dytat (të tallurat) janë më të mira se të parat (tallëset). As mos e përgojoni njëri-tjetrin e mos e fyeni njëri-tjetrin duke ngjitur nofka. Sa keq është të fyesh vëllain tënd pasi të ketë besuar. Dhe kushdo që nuk pendohet, atëherë të kë sillët janë keqbërës.” [Sure Huxhurat: 11]

“Ndhmoni njëri-tjetrin për mirësi, dëlirësi, përkushtim e frikë (ndaj Allahut) dhe mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gynah e padrejtësi (duke kaluar kufijtë).” [Sure El-Maide: 2]

“Padyshim që besimtarët janë vëllezër (në Islam).” [Sure Huxhurat: 10]

“Dhe që (I rregullojnë) punët e tyre me këshillim e konsultim midis tyre.” [Sure Esh-Shura: 38] E shumë ajete të tjera që kanë lidhje me këtë temë.

Është e ditur se asnjë prej individëve të shoqërisë kushdo qoftë ai, nuk shpëton dot prej armikut apo hasmit, i cili është prej shoqërisë në të cilën jeton, prej njerëzve apo prej xhindëve. Thuhet në një poezi:

Nëse njeriu në majën e malit vetminë kërkon

Prej armikut të tij jo kurrë nuk shpëton.

Pra, çdo individ i shoqërisë ka nevojë të gjejë ilaçin e kësaj sëmundjeje e cila i ka përfshirë të gjithë. Allahu i Lartëmadhëruar e ka sqaruar ilaçin e saj në tre vende në Librin e Tij. Ai ka sqaruar në to se nëse armiku është njeri, ilaçi i saj është që të mos e vësh re të keqen që ai të bëri duke u mënjanuar, madje t’ia kthesh me mirësi e dëlirësi. Kurse për sa i përket shejtanit prej xhindëve ai nuk ka ilaç përveç se kërkimin e mbrojtjes së Allahut prej të keqes së tij.

Vendi i parë: Allahu i Lartëmadhëruar thotë në fund të sures El-A’raf në lidhje me rastin kur është njeri:

“Trego mëshirë dhe urdhëro për të mirë dhe largohu prej të paditurve (mos i ndëshko ata).” [Sure El-A’raf: 199]

E nëse ai është prej shejtanëve xhind thotë:

“Edhe nëse të vjen ndonjë përshpëritje e ligë prej shejtanit, atëherë kërko mbrojtje e mbështetje tek Allahu. Vërtet Ai është Gjithëdëgjues, i Gjithëditur.” [Sure El-A’raf: 200]

Vendi i dytë: Ndodhet në suren El-Mu’minun ku Allahu i Lartësuar thotë:

“Largoje të keqen me atë gjë që është më e mira. Ne e dimë më së miri për çfarë ata flasin.” [Sure El-Mu’minun: 96]

Në një ajet tjetër për palën tjetër (shejtanin) thotë:

97- “Dhe thuaj: Zoti im! Të mbështetem ty (të më ruash) nga përshpëritjet e shejtanit.

98- Dhe të mbështetem Ty o Zoti im, se përndryshe ata do të më afroheshin.” [Sure El-Mu’minun: 97-98]

Vendi i tretë: Ndodhet në suren Fusilet. Allahu i Lartëmadhëruar ka shtuar në të se ky ilaç qiellor e ndërpret këtë sëmundje shejtanore. Në të po ashtu thuhet se ky ilaç qiellor nuk i jepet kujtdo, por i jepet atij që ka virtyte të larta dhe që e meriton denjësisht atë. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

34- “Largojeni të keqen me atë që është më e mirë (duke u përmbajtur e duke i falur ata që sillen keq). Pastaj ja, ai mes të cilit dhe mes teje pati armiqësi, (do të bëhet) si të ishte mik i ngushtë.

35- "Por askujt nuk i dhurohet kjo përveç atyre që janë të duruar dhe askujt nuk i dhurohet kjo përveç atij që do të gëzojë pjesë të madhe (dhe fat madhështor).” [Sure Fussilet: 34-35]

Në një ajet tjetër për palën tjetër (shejtanin) thotë:

“Dhe në qoftë se ndonjë pëshpëritje e ligë nga shejtani mundohet të të largojë ty (nga të bërit mirë), atëherë kërko mbrojtje tek Allahu. Vërtetë Ai është Gjithëdhëguesi, i Gjithëdituri.” [Sure Fussilet: 36]

Në disa vende të tjera në Kur’an ka treguar qartë se kjo butësi dhe tolerancë është vetëm për muslimanët e jo për jobesimtarët. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Atëherë Allahu do të sjell një popull të cilin ai do ta dojë dhe ata do ta duan atë, të përulur ndaj besimtarëve, të rreptë ndaj jobesimtarëve.” [Sure El-Maide: 54]

“Muhamedi është i dërguari i Allahut dhe ata që janë me të janë të ashpër ndaj mohuesve (të Allahut) dhe të mëshirshëm ndërmjet tyre.” [Sure El-Fet’h: 29]

“O peygamber! Lufto fort kundër jobesimtarëve dhe hipokritëve dhe ji i ashpër kundër tyre.” [Sure Et-Teube: 73 dhe Et-Tahrim: 9]

Duhet të dimë se ashpërsia aty ku kërkohet butësi është çmenduri dhe ngathtësi, kurse butësia në vendin e ashpërsisë është dobësi dhe pafuqishmëri.

Nëse të përmendin ty butësinë,

I thuaj se butësia ka vendin e vet.

Dhe butësia e djaloshit është injorancë,

kur nuk është në vendin e vet.

ÇËSHTJA E GJASHTË: EKONOMIA

Kur'ani i ka sqaruar shumë bukur bazat e saj tek të cilat kthehen të gjitha degët e saj. Çështjet e ekonomisë kthehen tek dy baza:

- 1- Zgjedhja e mënyrës më të mirë për fitimin e pasurisë.
- 2- Zgjedhja e mënyrës më të mirë për shpenzimin e saj, duke e shpenzuar atë aty ku duhet.

Vini re se si Allahu na ka begatuar duke na sqaruar në Librin e Tij rrugët e fitimit të pasurisë në atë mënyrë që është e përshtatshme, me shpirtmadhësi, sensin e nderit dhe fesë. Ai, i Lartësuarit ka hedhur dritë rreth kësaj çështjeje duke thënë:

“Pastaj kur të mbarojë falja (namazi), atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni mirësinë e Allahut (me punë të ndryshme) dhe kujtojeni Allahun shumë që të mund të jeni të shpëtuar.” [El-Xhumuah: 10]

“Të tjerë në udhëtim në tokë duke kërkuar begatinë e Allahut.” [El-Muzzemil: 20]

“Nuk ka asnjë gjynah për ju nëse kërkoni nga mirësitë e Zotit tuaj (gjatë haxhit, si marrja me tregti, etj.).” [Sure El-Bekareh: 198]

“...përveç se me anë të marrëdhënieve e të marrëveshjeve të drejta bashkëpunimi e tregtare midis jush.” [Sure En-Nisa': 29]

“Ndërsa Allahu e ka lejuar tregtinë.” [Sure El-Bekareh: 275]

“Kështu që kënaquni me çfarë morët si plaçkë lufte të lejuar (të ligjshme) e të mirë.” [Sure El-Enfal: 69]

E shumë ajete të tjera.

Vini re se si ka urdhëruar Allahu për mirëtrajtim dhe ekonomi gjatë shpenzimit duke thënë:

“Dhe mos i mbaj duart e lidhura (si koprac) pas qafe, as mos e shtri atë plotësisht (si shkapërdar).” [Sure El-Isra: 29]

“Edhe ata të cilët kur shpenzojnë nuk janë as shpërdorues, as dorështrënguar por mbajnë një të mesme të drejtë mes dy anëve.” [Sure El-Furkan: 67]

“Të pyesin ty se çfarë duhet të japin? Thuaj: Atë që është mbi nevojat tuaja (tepricën).” [Sure El-Bekare: 219]

Shiko se si Allahu na ka ndaluar që të shpenzojmë aty ku nuk lejohet të shpenzojmë duke thënë:

“Dhe kështu do të vazhdojnë ta shpenzojnë, por në fund do të jetë dhimbje për ta, pastaj do të jenë plotësisht të humbur.” [Sure El-Enfal: 36]

ÇËSHËTJA E SHËTATË: POLITIKA

Kurani i ka sqaruar shenjat e saj dhe ka hedhur dritë mbi shenjat dhe rrugët e saj. Ajo e ka originën prej qeverisjes dhe drejtimit të punëve. Politika ndahet në dy lloje: e brendshme dhe e jashtme.

Politika e jashtme bazohet në dy gjëra:

1- Pregatitja e fuqisë së mjaftueshme për mposhtjen e armikut. Allahu i i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe bëni gati kundër tyre të gjithë fuqinë që keni, bashkë me kalorësinë për të frikësuar armikun e Allahut dhe tuajin.” [Sure El-Enfal: 60]

2- Bashkimi i saktë dhe i përgjithshëm rreth kësaj fuqie. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe kapuni të gjithë ju së bashku me litarin (fenë dhe Kura'nin) e Allahut e mos u përçani.” [Sure Ali Imran: 103]

Gjithashtu thotë:

“Mos u kundërshtoni me (njëri-tjetrin) që të mos e humbisni kurajon dhe të mos ju lënë fuqitë.” [Sure El-Enfal: 46]

Kur'ani e ka treguar qartë se çfarë duhet të ndjekim ne në lidhje me marrëveshjen e paqes, armëpushimin dhe prishjen e marrëveshjes së paqes nëse kemi nevojë për të. Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

“Kështu që përmbushni marrëveshjen e paqes me ta deri në një.” [Sure Et-Teube: 4]

“Për sa kohë që ata janë besnik ndaj jush edhe ju u qëndroni besnikë atyre.” [Sure Et-Teube: 7]

“Në qoftë se ti (Muhamed) ke frikë nga tradhëtia e çfarëdo populli, atëherë edhe ti ua hidh (marrëveshjen) atyre që të jeni të barabartë.” [Sure El-Enfal: 58]

“Dhe ky është një kumtim nga Allahu dhe i dërguari i Tij drejtuar të gjithë njerëzve në ditën e haxhit të madh, se Allahu është distancuar (tërhequr) prej (marrëveshjes së) idhujtarëve e njëkohësisht edhe i Dërguari i Tij.” [Sure Et-Teube: 3]

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që të jemi në parapërgatitje e të ruhemi prej dinakërisë së tyre dhe të mos i lejojmë atyre asnjë rast për të na sulmuar befasisht. Allahut thotë:

“O ju që keni besuar! Parapërgatituni!” [Sure En-Nisa’: 71]

“T’i marrin të gjitha masat dhe t’i mbajnë armët e tyre me vete. Ata që nuk besojnë duan që ju të jeni të pakujdesëm për armët dhe pajisjet tuaja, e atëherë t’ju sulmojnë me një vërshim të vetëm.” [Sure En-Nisa: 102]

Kurse politika e brendshme përqendrohet në përhapjen e paqes, sigurisë dhe qetësisë në popull dhe në shoqëri. Gjithashtu merret me ndalimin e padrejtësisë dhe që çdo individ i shoqërisë të gëzojë të drejtat e tij. Bazat kryesore mbi të cilat është ndërtuar politika e brendshme janë gjashtë:

1- Mbrojtja e fesë.

Sheriati na ka urdhëruar që ta mbrojmë atë, prandaj peygamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) thotë: “Ai që ndërron fenë e tij, vriteni!” [Trans. Buhariu nga ibn Abbasi] Pra, duket qartë mbrojtja e theksuar prej ndërrimit apo humbjes së fesë.

2- Mbrojtja e jetës.

Allahu i i Lartëmadhëruar na ka urdhëruar në Kur'an që ti ruajmë vetet tona. Thotë:

“Ju është detyruar kisasi (ligji i barazisë në ndëshkim) në rast vrasjeje.” [Sure El-Bekare: 178]

“Kisasi (kjo masë e dënimit) është jetë për ju (ashtu që të ruheni nga mbytja e njëri-tjetrit).” [Sure El-Bekare: 179]

“Kushdo që vritet pa të drejtë (me qëllim armiqësie dhe shtypje dhe jo gabimisht ose padashje), Ne i kemi dhënë trashëguesit të tij (të të ndjerit) fuqinë (për të kërkuar kisasin).” [Sure El-Isra: 33]

3- Mbrojtja e mendjes.

Kur'ani na ka urdhëruar që ti ruajmë mendjet tona. Allahu i Lartësuar thotë:

“O ju që keni besuar! Të gjitha pijet alkolike dehëse e marramendëse, kumari (bixhozi), anabet (altarët ku flijohen kurbanë për idhujt), azlamet (hedhja e shortit ose kërkimi i fatit me shigjeta) janë të neveritura e punë prej shejtanit, kështu që hiqni dorë prej të gjitha atyre (rreptësisht nga të gjitha punët e neveritura) që të mund të jeni të shpëtuar.” [Sure El-Maide: 90]

Peygamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) thotë: “Të gjitha pijet dehëse janë të ndaluara, e çdo lloj pije prej së cilës kur pi shumë të deh, atëherë edhe nëse është pak, ajo është e

ndaluar.” Masa e dënimit që është e detyrueshme për atë që pi alkool, është vendosur për shkak të mbrojtjes së mendjeve.

4- Mbrojtja e lidhjes së gjakut

Për shkak të ruajtjes së saj, Allahu ka obliguar masën e dënimit të imoralitetit. Allahu i i Lartëmadhëruar thotë:

“Gruan dhe burrin, që fajtor për marrëdhënie të paligjshme jashtë martese, fshikulloni secilin prej tyre me njëqind kamzhikë.” [Sure En-Nur:2]

5- Mbrojtja e nderit

Për këtë Allahu ka obliguar si masë dënimi për shpifësin tetëdhjetë kamzhikë. Ai thotë:

“Dhe ata që akuzojnë gra të dëlira dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i fshikulloni me tetëdhjetë kamzhikë.” [Sure En-Nur:4]

6- Mbrojtja e pasurisë

Për këtë arsye Allahu ka obliguar prerjen e dorës së vjedhësit, kur thotë:

“Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart (të djathtën në kyç) si shpërblim për atë çfarë kanë kryer, ndëshkim për t'u bërë shembull nga Allahu.” [Sure El-Maide: 38]

Pra, u duk qartë se ndjekja dhe zbatimi i Kur'anit është përkujdesje për shoqërinë në të gjitha aspektet dhe interesat, të brendshme dhe të jashtme.

ÇËSHËTJA E TETË: DOMINIMI I JOBESIMTARËVE MBI MUSLIMANËT

Kjo çështje iu duk problematike edhe shokëve të pejgamberit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), ndërkohë që ai (pejgamberi) ishte midis tyre. Atëherë Allahu i Madhëruar dha një përgjigje në librin e Tij, një përgjigje qiellore e cila e largoi menjëherë këtë problem. Kjo ngjarje ndodhi kur muslimanët u goditën në ditën që u zhvillua beteja e Uhudit. Atyre kjo gjë iu duk problematike, prandaj thanë: Si ka mundësi të triumfojnë jobesimtarët ndaj nesh e të dominojnë mbi ne kur ne jemi me të vërtetën dhe ata janë me të kotën? [Trans. Ebi ibn Hatim në tefsirin e tij prej Hasan Basriut]

Atëherë Allahu i Lartësuar ua dha përgjigjen duke thënë:

“(Si është puna me ju) Kur ju godet një fatkeqësi e vetme, megjithëse i shpartalluat (armiqtë tuaj) dy herë më shumë, përsëri thoni: Nga na erdhi ne kjo? Thuaju: Është nga vetë ju (për shkak të veprave tuaja të ulta).” [Sure Ali Imran: 165]

Fjala e Allahut: “Thuaju: Është nga vetë ju.” Është sqaruar shumë bukur me fjalën tjetër të Tij kur thotë:

“Dhe me të vërtetë Allahu e përmbushi premtimin e Tij kur ju po i asgjesonit ata (armiqtë tuaj) me Lejen dhe Vullnetin e Tij, derisa erdhi çasti që humbët durimin dhe filluat të grindeni me njëri-tjetrin për rregullin, pastaj nuk e zbatuat atë, pasi Ai ju tregoi juve (plaçkën e luftës), atë që ju donit. Nga mesi juaj ka disa që dëshirojnë këtë botë dhe disa që dëshirojnë Botën e Pastajme. Pastaj Ai ju bëri juve t’ia mbathni këmbëve prej tyre (armiqve tuaj), me qëllim që Ai të mund t’ju provonte ju.” [Sure Ali Imran: 152]

Në këtë përgjigje qiellore u duk qartë se shkak i dominimit të jobesimtarëve mbi ta erdhi nga vetë ata kur e humbën durimin dhe filluan të grinden me njëri-tjetrin për rregullin, kur disa prej tyre kundërshtuan të dërguarin dhe donin të mirat e kësaj bote. Kjo ndodhi kur shigjetarët të cilët ndodheshin në majën e malit duke ndaluar jobesimtarët që të mos i afroreshin muslimanëve nga pas krahëve, dëshiruan plaçkën e luftës kur u zbrampsën idhujtarët në fillim të betejës. Ata e lanë urdhërin e të Dërguarit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) për të arritur një interes të kësaj bote. [Këtë ngjarje e trans. Buhariu nga El-Bera' bin A'zib]

ÇËSHTJA E NËNTË: DOBËSIMI I MUSLIMANËVE NË NUMËR E FUQI NË KRAHASIM ME JOBESIMTARË

Allahu i Lartëmadhëruar e ka sqaruar ilaçin e kësaj çështje në Librin e Tij. Ai ka treguar se shikon sinqeritetin në zemrat e robërve të Tij. Nëse sinqeriteti është ashtu si duhet, atëherë ka për të qënë përfundimi i kësaj çështjeje se do ta mposhtin dhe do të triumfojnë kundra asaj pale që është më e fortë se ata. Prandaj kur vuri re sinqeritetin sikurse duhet tek Ehlul Bej'ati Riduan , e përmendi sinqeritetin e tyre duke thënë:

“Sigurisht që Allahu ishte i kënaqur me besimtarët kur ata të dhanë besën ty (Muhamed) nën pemë. Ai e dinte mirë çfarë kishte në zemrat e tyre.” [Sure El-Fet’h: 18]

Ai gjithashtu sqaroi se nga përfundimet e atij sinqeriteti ishte edhe fuqia që Ai ua dha atyre për atë ç’ka ata nuk kishin fuqi, duke thënë:

“Dhe të tjera (fitore dhe mjaft plaçkë lufte Ai ua premton juve) të cilat nuk janë akoma nën fuqinë tuaj. Vërtet që Allahu i përfshin ato.” [Sure El-Fet’h: 21]

Pra, këtu tregoi qartë se ata nuk kishin fuqi për to e se Allahu i përfshin ato dhe i mundësoi ata që t'i merrnin duke e bërë plaçkë lufte për ta kur vuri re sinqeritetin e tyre. Në luftën e Ahzabit kur u dyndën jobesimtarët kundër muslimanëve duke i rrethuar në një mënyrë ushtarake madhështore, të cilën e ka përmendur Allahu duke thënë:

10- “Kur ata u dyndën mbi ju nga sipër jush e nga poshtë jush, dhe kur sytë u egërsuan dhe zemrat u erdhën në fyt (pothuajse u ngriu gjaku), dhe po ushqenit dyshime për Allahun.

11- "Atje besimtarët u sprovuan dhe u tundën nga një tronditje e madhe.” [Sure El-Ahzab: 10-11]

Kur ata ishin në këtë gjendje, ilaçi i vetëm për të përballuar këtë dobësi dhe këtë rrethim strategjik ishte vetëm sinqeriteti i vërtetë për Allahun dhe besimi i fortë e i palëkundur tek Ai. Allahu i i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe kur besimtarët i panë ahzabët, thanë: Kjo është ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij (Muhamedi) na kishin premtuar dhe Allahu dhe i dërguari i Tij (Muhamedi) kanë folur të vërtetën. Dhe kjo veç ua shtoi besimin dhe nënshtrimin (ndaj Allahut).” [Sure El-Ahzab: 22]

Prej përfundimeve të atij sinqeriteti, ishte dhe ai përfundim në favor të muslimanëve, për të cilin Allahu thotë:

25- "Dhe Allahu i përzuri ata që mohuan në zemërimin e tyre (dhe) ata nuk përfituan asnjë mirësi. Allahu u mjaftoi besimtarëve në luftë (duke dërguar erë të fortë dhe melekë në radhët e bashkuara të ushtrive armike). Dhe Allahu është gjithnjë Fuqiplotë, i Gjithëfuqishëm.

26- "Edhe ata nga ithtarët e Librave të parë të cilët i mbështetën ata (paganët e jobesimtarët), Allahu i rrëzoi nga fortesat e tyre dhe futi tmerr në zemrat e tyre. Një pjesë ju i vratë dhe një pjesë tjetër i morët robër.

27- "Dhe Ai bëri që ju të trashëgonit tokat e tyre edhe shtëpitë e tyre, edhe pasuritë e tyre dhe një vend të cilin ju nuk e kishit shkelur më parë. Dhe Allahu është gjithnjë i Zoti për të bërë çdo gjë." [Sure El-Ahzab: 25-27]

Ajo me të cilën Allahu i ndihmoi ata ishte era dhe melekët, ndihmë të cilën ata e mendonin dhe e prisnin. Allahu i i Lartëmadhëruar thotë:

“O ju që keni besuar! Përkujtoni mirësinë e Allahut mbi ju kur erdhën kundër jush ushtri (të mëdha) dhe Ne dërguam kundër tyre erë dhe forca që ju nuk i patë dot (melekë).” [Sure El-Ahzab: 9]

Nga argumentet që tregojnë se Islami është fe e vërtetë, është edhe fakti se një grup i vogël, nëse është i kënaqur me këtë fe ashtu siç duhet, i mund grupet e tjera të forta jobesimtare të cilat janë mbledhur si hordhi. Allahu i Lartësuar thotë:

“Sa shpesh një grup i vogël ka mundur një hordhi të madhe me Vullnetin dhe Lejen e Allahut! Dhe Allahu është me durimtarët.” [Sure El-Bekare: 249]

Allahu i Lartësuar e ka quajtur Ditën e Bedrit: Shenja, Dita e së Vërtetës (gjykimit mes të drejtës e të gabuarës) dhe prova e qartë. E gjithë kjo argumenton se Islami është fe e vërtetë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Tashmë sapo kaloi një shenjë për ju (çifutë) në të dy ushtritë që u takuan (në betejë mes tyre) . Njëra luftonte për çështjen e Allahut, ndërsa tjetra (ata) ishin mohues.” [Sure Ali Imran: 13]

“Në qoftë se ju vërtet keni besuar në Allahun dhe në atë që Ne ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit) në Ditën e të Vërtetës (gjykimit mes të drejtës e të gabuarës).” [Sure El-Enfal: 41]

Përsëri Allahu thotë:

“Në këtë mënyrë, ata që do të thyheshin të mund të shkatërroheshin pas një prove të qartë dhe ata që do të jetonin (besimtarët), të mund të jetonin pas një prove të qartë.” [Sure El-Enfal: 42]
Këtu është për qëllim Dita e Bedrit siç e kanë vërtetuar shumë prej dijetarëve.

Fakti që një grup i vogël, i dobët e besimtar triumfon ndaj hordhisë së fuqishme jobesimtare, nuk ka dyshim që argumenton se ai (grupi i vogël, i dobët e besimtar) është me të vërtetën dhe se Allahu i Lartëmadhëruar është Ai që i nxorri ata fitimtarë. Allahu i Lartëmadhëruar thotë në lidhje me luftën e Bedrit:

“Dhe më parë Allahu ju nxorri fitimtarë në Bedër kur ju ishit një forcë e vogël dhe e dobët.” [Sure Ali Imran: 123]

“(Përkujto) Kur Zoti yt i frymëzoi melekët: Vërtet Unë jam me ju, mbroni pra dhe jepuni forcë besimtarëve! Unë do t’ua fus tmerrin në zemër jobesimtarëve.” [Sure El-Enfal: 12]

Besimtarët janë ata që u ka premtuar Allahu ndihmë dhe fitore. Allahu i Lartësuar i ka treguar cilësitë e tyre dhe i ka veçuar ata nga të tjerët. Ai thotë:

“Dhe nuk ka dyshim se Allahu do t'i ndihmojë ata të cilët ndihmojnë (çështjen) e Allahut.” [Sure Haxh: 40]

Kurse një ajet më pas i ka veçuar ata me cilësitë e tyre duke thënë:

“Ata (sundues muslimanë) të cilët nëse Ne u japim fuqi në tokë, urdhërojnë për plotësimin e faljeve të rregullta ditore (në xhami) dhe për zekatin, që urdhërojnë për të mirën (Besimin dhe ligjin Islam) dhe ndalojnë të keqen (çdo gjë që e ka ndaluar islami). Dhe tek Allahu mbështetet përfundimi i të gjitha çështjeve.” [Sure Haxh: 41]

Përsa i përket ilaçit për të cilin treguam se është ilaç për rrethimin ushtarak, Allahu i Lartëmadhëruar ka treguar në suren Munafikun se është gjithashtu ilaç edhe për rrethimin ekonomik. Ai thotë:

“Ata janë të cilët thonë: Mos shpenzoni për ata të cilët janë me të Dërguarin e Allahut, derisa ata ta braktisin atë.” [Sure El-Munafikun:7]

Ky gjest që bën munafikët (hipokritët) me muslimanët është vetë rrethimi ekonomik. Allahu i Lartëmadhëruar na ka treguar se ilaçi i tij është forca e besimit dhe drejtimi i sinqertë tek Allahu. Ai thotë:

“E Allahut i përkasin thesarët e qiejve e të tokës, por hipokritët nuk kuptojnë.” [Sure El-Munafikun: 7]

Dihet shumë mirë se kujt i përkasin thesarët e qiejve e të tokës, Ai nuk e humbet atë që i drejtohet sinjerisht duke iu bindur Aij. Allahu i Lartësuar thotë:

2- "Dhe kushdo që ka frikë Allahun dhe përmbush detyrimin ndaj Tij, Ai do të tregoj rrugë për të dalë nga (çdo vështirësi)".

3- "Dhe Ai do t'i sjellë atij rrizk (furnizim e të mira) prej nga ai as nuk mund ta mendonte. Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, atëherë Ai do t'i mjaftojë atij plotësisht." [Sure Et-Talak: 2-3]

Përsëri thotë:

“Edhe po të keni frikë urinë, Allahu do t’ju pasurojë nga begatitë e Tij, nëse Ai do.” [Sure Et-Teube: 28]

ÇËSHITJA E DHJETË: PROBLEMI I PËRÇARJES SË ZEMRAVE

Allahu i i Lartësuar ka sqaruar në suren El-Hashr se shkaku i këtij problemi është moslogjikimi. Ai thotë:

“Ju mund t’i mendoni si të bashkuar ata, por zemrat e tyre janë të ndara.” Kurse më pas shpjegoi shkakun duke thënë:

“Kjo ndodh se ata janë popull që nuk marrin vesh.” [Sure Hashr: 14]

Ilaçi i dobësisë së mendjes është ndriçimi i saj me ndjekjen e dritës së shpalljes, sepse shpallja udhëzon për në përfitimet dhe interesat madhështore të cilat mendjet nuk arrijnë t'i kuptojnë me lehtësi.

Allahu i Lartësuar thotë:

“A mos vallë është njësoj ai i cili ishte i vdekur (pa besim nga padija dhe mosbesimi) dhe Ne që i dhamë atij jetë (me dije e besim) duke i vënë atij një dritë (besimi) me anë të së cilës ai të eci mes njerëzve, me atë i cili është në errësirë (mosbesim, besim në shumë zota dhe në hipokrizi) nga e cila kurrë nuk mund të dalë.” [Sure En-Aam: 122]

Në këtë ajet tregoi qartë se drita e besimit i jep jetë atij që është i vdekur dhe ia ndriçon rrugën në të cilën ecën. Allahu i i Lartësuar thotë:

“Allahu është Mbrojtësi dhe Ruajtësi i atyre që e besojnë atë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.” [Sure Bekare: 157]

Po ashtu thotë:

“A është në udhë të drejtë (të besimit të vërtetë) ai i cili ecën kokëngulthi me fytyrë të poshtëruar më drejt i udhëzuar apo ai i cili (sheh dhe) ecën i matur. [Sure Mulk: 22]

Shkurtimisht, interesat njerëzore me të cilat kryhet sistemi i kësaj bote kthehen në tre gjëra:

E para

Mbyllja e pragut të së keqes para se ajo të ndodhë. Tek dijetarët e rregullave të fikhut njihet me emrin: Gjërat e domosdoshme, largimi i dëmit prej atyre gjashtë gjërave të cilat i përmendëm më lartë: d.m.th,

1- Feja 2-Vetja 3- Mendja 4- Lidhja e gjakut 5- Nderi dhe 6- Pasuria

E dyta

Sjellja e të mirave ose siç njihet ndryshe: Gjërat e nevojshme. Prej gjërave që degëzohen prej saj janë: shitblerja, qeraja dhe të gjitha interesat e tjera që përdorin anëtarët e shoqërisë duke u bazuar në sheriatin Islam.

E treta

Stolisja me moralim e lartë dhe praktikimi i traditave të mira. Këtu hyjnë dhe gjërat e natyshmërisë si: lënia e mjekrës, shkurtimi i mustaqeve...etj.

Po ashtu hyn edhe ndalimi i gjërave të neveritura, shpenzimi i pasurisë për të afërmit e të varfërit. Gjëja që duhet mbrojtur më shumë nga të gjitha këto interesa është feja, "Elif-Lam-Ra. Ky është një libër, vargjet të cilit janë përsosur (në çdo fushë të dijes) dhe pastaj janë shpjeguar me imtësi nga Një (Allahu) i Cili është më i Urti Gjithëgjykues, i Mirënjohur (deri në imtësi për çdo gjë)." [Hud: 1]